

[Data 15/11/2022]

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “PROJEKTI I CENTRALIZIMIT TË NYJEVE SEMAFORIKE ME QENDRËN E KONTROLLIT DHE MENAXHIMIT TË TRAFIKUT”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45316210-0 Instalime të pajisjeve që monitorojnë trafikun; 32412100-5 Rrjeti i telekomunikacionit; 71322500-6 Shërbime për projektme teknike të infrastruktures së trafikut

Vlera e Fondit Limit: 81.040.227 (tetëdhjetë e një milion e dyzetë mijë e dyqind e njëzet e shtatë) lekë (referuar strukturës së preventivit), ose 693.007 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e shtatë) Euro.

** Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 15/11/2022 është 116.94 Lekë/Euro*

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë me anë të V.K.B-së Nr.166, datë 24.12.2021 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2022-2024 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2022”, i ndryshuar.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:

Arsyeja kryesore e mosndarjes së procedurës së prokurimit në lote është se referuar preventivit të shërbimeve, aparaturave dhe pajisjeve të lidhura me shërbimin e kërkuar, specifikimeve teknike/Termave të Referencës, Autoriteti Kontraktor e ka të pamundur teknikisht ta ndajë këtë kontratë në lote të veçantë pasi do e bënte shumë të vështirë për tu menaxhuar.

Kjo procedurë shërbimi duhet të kryhet në një lot të vetëm, pasi lloji i shërbimit për të qenë sa më efikas duhet të jetë i përqëndruar tek një operator ekonomik. Kryerja nga një operator ekonomik e bën më efektiv organizmin e punës por sidomos e bën shumë më të përshtatshëm monitorimin dhe raportimin e të gjitha proceseve të punës që ky shërbim ka. Ndarja në lote do të

sillte konfuzion pasi të gjithë zërat e kërkuar për ofrimin e shërbimit janë procese të lidhura ngushtë me njëra tjetrën dhe ndarja e tyre në lote do të sillte crregullim në proces dhe vështirësi në monitorim të shërbimit si dhe kosto shtesë për AK. Të gjithë zërat e artikujve të shërbimit, punimeve dhe aparatave e pajisjeve që do ofrohen për instalimin, konfigurimin dhe zhvillimin e proceseve sipas kërkesave të AK janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën, pra janë të gjithë si një komponent i vetëm në funksion të njëra tjetrës. Operatori ekonomik fitues duhet të realizojë, integrimin në platformën qendrore të disa nyjeve semaforike të cilat nuk janë të centralizuara, si dhe rinovimi i infrastrukturës datacentër, ku për këtë qëllim operatori ekonomik duhet të furnizojë, instalojë dhe konfigurojë të gjithë elementët e nevojshëm për të arritur rezultatin e kërkuar.

Në këto kushte, duke qënë se kemi të bëjmë me një familje artikujsh të vetëm dhe si i tillë nuk pengon operatorët ekonomikë të marrin pjesë në procedurën objekt prokurimi gjykojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë dhe në përputhje me frymën e legjislacionit.

Për këtë arsye, është e pamundur që zërat e shërbimeve të ndahen në grupe ose vec e vec secili, pasi do të vështirësonte realizimin e kontratës, ndaj AK ka vendosur që këtë procedurë ta zhvillojë pa e ndarë në lote.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, si dhe shtojcës 8 të DST-së.*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, ku vlera e xhiros minimale për një periudhë deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare të jetë në një vlerë jo më të vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet, lëshuar nga autoriteti përkatës. Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur edhe nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

.... dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;". Kjo procedurë është mbi kufirin e lartë monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

2.2.2 Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2019, 2020, 2021) që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, Dega e Tatim Taksave, të konfirmuara nga ky autoritet, si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar vetëm në rastet kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c", të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

*Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga O.E vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".*

2.2.3 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKR).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar.

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale.

Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2021 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me:

- a) Standartin ISO 9001 (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

- b) Standartin ISO 27001 (e përditësuar) për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme), dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi

kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt- marrëveshjes.

- c) Operatori ekonomik duhet të jetë i çertifikuar me standartin ISO 20000-1 (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të shërbimit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Nisur nga proceset e punes kritike, rendësisë së shërbimeve që sistemi ofron, gjykohet e arsyeshme që operatori ekonomik proceset e punes së tij, ti bazojë në standarde botërore, të cilat në mënyrë direkte ndikojnë në cilësi, shpejtesi, efikasitet dhe të shërbimeve të ofruara, konkretisht:

a) ISO 9001 (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të cilësisë:

Argumentimi: ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Sistemi i menaxhimit të cilësisë siguron që operatori zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë, kërkesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilësor të tij.

Kërkesa për ISO 9001 është një kërkesë e domosdoshme për të realizuar suksesin e kontratës.

b) ISO 27001 (e përditësuar) për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit:

Argumentimi: ISO 27001 është një kuadër standartizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomikë në lidhje me :

- mirëmbajtjen e sistemit ISMS (Information Security Management System) brenda vetë organizatës së operatorit ekonomik.
- aplikimin e praktikave të sigurisë për menaxhimin e risqeve të sigurisë.
- aplikimin e praktikave të sigurisë për trajtimin e të dhënave sensitive.
- aplikimin e masave dhe praktikave të sigurisë për shërbimet e kryera në ambiente sensitive.

Referuar sa më sipër cituar, ky standard lidhet drejtpërdrejt me zërat e kërkuara në termat e references.

Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit siguron që operatori ekonomik aplikon, suporton dhe përmirëson në mënyrë të vazhdueshme një përqasje sistematike në menaxhimin e informacionit sensitiv me fokus tek siguria dhe transparencia.

Referuar sa më sipër, disponueshmëria e certifikatës ISO 27001, parë kjo në raport me natyrën e furnizimeve dhe shërbimeve të kërkuara, ndërhyrje në infrastrukturën ekzistuese dhe trajtimin e informacionit konfidencial gjatë implementimit të saj, është një kërkesë në përpjesëtim të drejtë me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet nga Autoriteti Kontraktor. Dhe është një kërkesë e domosdoshme për realizimin me sukses të kontratës.

c) ISO 20000-1 (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të shërbimit:

Argumentimi: ISO 20000-1 është një kuadër standardizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomikë për: ndjekjen konsistente të shërbimeve deri në kryerjen e plotë të tyre sipas kërkesave të DST-së. Standardi ISO 20000-1 përcakton kriteret për planifikimin, krijimin, menaxhimin, monitorimin, rishikimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e qasjes së menaxhimit të shërbimeve që fokusohet në teknologjitë e informacionit.

Kjo certifikatë siguron Autoritetin Kontraktor që të gjitha shërbimet IT do të menaxhohen sipas standardeve më të mira të shërbimeve të teknologjisë së informacionit.

Menaxhimi i shërbimit IT siguron që operatori ekonomik ka të implementuar një sistem ofrimi të shërbimit përmes të cilit efektivisht planifikon, implementon, operon, monitoron dhe kontrollon portofolin e shërbimeve dhe cilësinë e tyre.

Këto kërkesa janë në vetvete një garanci më tepër për suksesin e projektit

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar për aparaturat/pajisjet e zërit 3, si dhe për software e platformës së menaxhimit. Në rast të paraqitjes së autorizimit të distributorit, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumenta për të vërtetuar lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit të autorizuar nga prodhuesi.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për mallrat e furnizuara (sisteme votimi elektronik), e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion përkatës. Autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave, dhe jep siguri për mirëfunktionimin dhe përmbushjen e qëllimit të tyre sipas ToR. Në këtë kontekst, referuar natyrës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dëshmive nga prodhuesi për pajisjet e ofruara, e cila është vendosur në përputhje me Specifikimet Teknike të procedurës, kërkon të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues për ofrimin e shërbimit cilesor, brenda afateve dhe parametrave të kërkuara.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të dëshmojë që ka stafin e nevojshëm teknik që do të angazhohet në implementimin e kontratës, me kompetencat minimalisht si më poshtë:

- a. Te pakten 2 (dy) punonjës të certifikuar për administrim windows server.
- b. Të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar për networking.
- c. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për sigurinë e informacionit
- d. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për backup software
- e. Të paktën 3 (tre) Inxhinierë të diplomuar në profilin Elektronik ose Inxhinieri Elektronike
- f. Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve SLA
- g. Të paktën 2 (dy) punonjës të pajisur me dëshmi të kualifikimit teknik për sigurimin teknik

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Konkretisht:

Neni 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pika 4:

[...Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...]

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 41, pika 4.

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose

komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

b) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa për staf është minimalisht e nevojshme për të garantuar Autoritetin Kontraktor se OE disponon kapacitetet me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen.

Në këtë kontekst, referuar natyrës, vlerës së kontratës dhe objektit të prokuruar, prania e stafit teknik të diplomuar sipas kërkesave të këtij kriteri, i jep siguri AK se Operatorit Ekonomik ka njohuritë dhe ekspertizën e duhur profesionale për realizimin e integritit, konfigurimeve, testeve dhe shërbimeve që do të mundësohen nëpërmjet kësaj kontrate (dhe jo vetëm) konkretisht:

a. Te paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për administrim windows server.

Argumentimi: Për të siguruar shërbime të sukseshme gjatë ekzekutimit të kontratës është e domosdoshme që OE të ketë në stafin e propozuar personel të certifikuar për administrimin e windows server, pra të sistemeve operative, të cilat janë objekt i rëndësishëm i këtij prokurimi, dhe pjesë e termave të referencës.

b. Të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar për networking.

Argumentimi: Kërkesa lidhet me praninë në stafin implementues të Operatorit, të një profesionisti të aktiviteteve të sigurisë së network, si një nga aktivitetet e vazhdueshme gjatë shërbimeve të instalimit apo konfigurim. Kërkesat e stafit teknik lidhen me nevojën për staf të specializuar për të realizuar detyrat specifike të projektit: dizenjimi teknik, instalimin, monitorimin e burimeve që kërkon në vijimësi sistemi, aksesin në sistem, implementimin e patcheve dhe upgrade të ndryshëm në sistemet xhenerike software, përshtatjen me sistemet software xhenerike apo të specializuara në терминаlet e përdoruesve, suportimin tërësor të sistemit, garantojë sigurinë e sistemit përmes politikave të aksesit së bashku me stafin e AK-së, do të garantojë kryerjen e detyrave specifike, Integrimi me rrjetin dhe shërbimet ekzistuese, Instalim përfundimtar i sistemit në ambientin ku do funksionojë.

c. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për sigurinë e informacionit

Argumentimi: Nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor kërkon të vërtetojë që punonjësi me certifikimin për sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit pjesë e stafit teknik të operatorit ekonomik, ka aftësi të planifikojë, të udhëheqë, të raportojë dhe të auditojë menaxhimin e sigurisë së informacionit në funksion të sistemit që do të ngrihet, si dhe të garantojë që sistemi është konform standardeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, në të gjithë hallkat funksionale të tij dhe si i tillë mund të menaxhojë në mënyrë të sigurt

informacionin. Objekti i prokurimit të kësaj procedure ka të bëjë me një sistem menaxhimi që përfshin role, procese dhe sisteme të teknologjisë së informacionit.

Prania e tij jep garanci edhe për sigurinë e informacionit dhe rrjedhës së tij gjatë realizimit të shërbimeve sipas Termave të Referencës

d. Të paktën 1 (një) punonjes të certifikuar për backup software.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 41 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Punonjësit e kërkuar janë të nevojshëm për zbatimin korrekt të kontratës, pasi duhet të zbatohen të gjitha standartet teknike për ofrimin e shërbimit të backup/ si dhe të menaxhohen të gjitha incidentet që mund të ndodhin gjatë këtij procesi. Është në të drejtën e Autoritetit Kontraktor të kërkojë garanci për realizimin me sukses të termave të referencës, përmes përfshirjes së një stafi të specializuar për realizimin e detyrave specifike dhe nevojave konkrete që mbart natyra e këtij projekti.

e. Të paktën 3 (tre) Inxhinierë të diplomuar në profilin Elektronik ose Inxhinieri Elektronike

Argumentimi: Kërkesat janë vendosur në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Nisur nga objekti i prokurimit, volumi dhe kompleksiteti i shërbimeve të kërkuara dhe Specifikimet teknike zërave për t'u prokuruar, kërkesa prej të paktën 3 (tre) Inxhinierë të diplomuar në profilin Elektronik ose Inxhinieri Elektronike, janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke qenë se profili i inxhinierëve të kërkuar është i domosdoshëm për realizimin e shërbimeve të kontratës.

f. Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve SLA

Argumentim: Plotësimi i kësaj kërkesë jep garanci më tepër që Operatori ekonomik garanton ideimin dhe konceptimin e shërbimeve IT të projektit në mënyrë të menaxhueshme sipas standardeve ndërkombëtare të njohura, në gjithë ciklin e tyre, përfshirë këtu dhe shërbimet e mirëmbajtjes dhe termat e SLA-së.

Menaxhimi i Shërbimeve IT është një set praktikash dhe kuadri rregullash dhe idesh për realizimin e shërbimit në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, që është pjese e qëllimit të projektit në fjalë.

g. Të paktën 2 (dy) punonjës të pajisur me dëshmi të kualifikimit teknik për sigurimin teknik

Argumentimi: Kriteri është hartuar në përputhje me Nenin 41-Kërkesa të vecanta për kontratat e shërbimeve, të VKM nr. 285, date 19/05/2021 Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës;

Në nenin 9 pika 1 gërma “a” të ligjit nr. 8734 datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të paisjeve dhe instalimeve elektrike”, parashikohet se “Formimi i punëmarrësve”

Punëdhënësi merr masat e nevojshme që: a) përdorimi i pajisjeve elektrike të bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, e lëshuar nga IPIE-ja ose nga komisioni i miratuar prej saj”. Në nenin 7 të ligjit nr.13/2013 “ Për disa ndryshime në ligjin nr. 8734 datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të paisjeve dhe instalimeve elektrike”, parashikohet se “Në nenin 9, shkronja “a” e pikës 1 ndryshohet si më poshtë: “a) Përdorimi i pajisjeve elektrike bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, të lëshuar nga një organ i akredituar certifikues personeli për fushën përkatëse. Kjo kërkesë është hartuar në përputhje me qëllimin dhe fazat e procedurës.

Një punonjës mund të ketë 1 ose më shumë certifikime.

Për të vërtetuar këtë operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Certifikata për specialistët e kërkuar;
- Listëpagesat sipas formularit E-Sig 025/a për muajin e fundit të deklaruara sipas legjislacionit në fuqi, paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B.

Kërkesa nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike (termave të referencës):

Termat e referencës/ Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Qendra e Kontrollit dhe e Monitorimit të Trafikut në Bashkinë e Tiranës aktualisht mundëson ndër të tjera si pjesë të njërit nga nënsistemet e saj të funksionimit të centralizuar të aparaturave semaforëve në kryeqytet, pra në tërësinë e aparaturave semaforike, pjesa dërmuese e aparaturave semaforike ekzistuese funksionojnë në të gjitha nivelet e parashikuara, në mënyrë të pamvarur, duke përfshirë nivelin e menaxhimit të planeve të trafikut në nivel lokal, si edhe në nivelin e menaxhimit të planeve të trafikut me komandim nëpërmjet qendrës MMST.

Prej Qendrës aktuale MMST behet procesimi në kohë reale i të dhënave të trafikut, pra vlerësimin e volumeve të trafikut në rrugët kryesore, si edhe dytësore, duke monitoruar arteriet më të përdorshme në një moment të caktuar të ditës, proces i cili realizohet si nëpërmjet sistemit CCTV por edhe sensorëve të vendosur, duke ju dhënë mundësinë operatorëve të Sektorit të MMST për të definuar dhe implementuar planet e menaxhimit të trafikut të përshtatshme për lëvizjen e automjeteve në infrastrukturën e Tiranës sipas orëve të caktuara të ditës.

Qendra e Kontrollit dhe e Monitorimit të Trafikut, ka në përdorim sisteme softuere, të cilat janë konceptuar të tilla që të përmirësojnë në mënyrë të konsiderueshme lëvizshmërinë e automjeteve private, të rrisë sigurinë rrugore, të zvogëlojnë vargjet e automjeteve në kryqëzime, duke ndikuar kështu në zvogëlimin e ndotjes së mjedisit dhe konsumin e lëndës djegëse. Gjithashtu, ky sistem informon në kohë reale përdoruesit e rrugës në lidhje me situatën e trafikut nëpërmjet shfaqjes së mesazheve informuese në tabelat elektronike me mesazhe të ndryshueshme, të instaluar në rrugët kryesore, si dhe në platformat (web).

Keto sisteme janë të instaluar në DataCenter qendror të Sektorit të MMST.

Qëllimi kryesor i sistemit është menaxhimi i trafikut rrugor nëpërmjet sistemeve inteligjente të transportit. Sistemi është konceptuar i tillë që të përmirësojë në mënyrë të konsiderueshme lëvizshmërinë e automjeteve private, të rrisë sigurinë rrugore, të zvogëlojë vargjet e automjeteve në kryqëzime, duke ndikuar kështu në zvogëlimin e ndotjes së mjedisit dhe konsumin e lëndës djegëse.

Gjithashtu, ky sistem informon në kohë reale përdoruesit e rrugës në lidhje me situatën e trafikut nëpërmjet shfaqjes së mesazheve informuese në tabelat elektronike me mesazhe të ndryshueshme, të instaluar në rrugët kryesore, si dhe në platformat (Web).

Qendra e MMST-së funksionon 24 orë në 7 ditë të javës, pandërprerje për menaxhimin e sistemeve, si më poshtë:

- *Nënsistemi i rrjetit Semaforik (UTC)*
- *Nënsistemi i kamerave (CCTV)*
- *Nënsistemi i Tabelave elektronike me mesazhe të ndryshueshme (VMS)*
- *Nënsistemi i Rrjetit të Telekomunikimit (TN)*
- *Nënsistemi i infrastruktures hostuese Datacenter (Server, Storage, Firewall, Core & Access Switches, etj)*
- *Info mobiliteti*
- *Aplikacionet dhe softuere të menaxhimit të mobilitetit, ku sistemi kryesor i monitorimit dhe menaxhimit të nyjeve semaforike në kohë reale (OMNIA, UTOPIA) dhe në nivel lokal aparaturat semaforike janë të tipit SCAE*

Qëllimi i shërbimit është zgjerimi i sistemit të menaxhimit qendror të trafikut nëpërmjet aparaturave semaforike, duke siguruar edhe centralizimin e disa nyjeve semaforike që aktualisht funksionojnë në nivel lokal, me Qendrën ekzistuese të Monitorimit e Menaxhimit të Sistemeve të Trafikut (MMST-së), duke përfshirë të gjithë komponentët mbështetës të tyre, përmirësimin e infrastruktureës ekzistuese, konfigurimin e Softuarëve përkatës si në nivel lokal dhe në nivel qendror të MMST-së, si dhe rinovimin e infrastrukturës së serverave me qëllim garantimin e funksionalitetit tërësor të sistemit në vijim.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Projekti i centralizimit të nyjeve semaforike me Qendrën e Kontrollit dhe Menaxhimit të Trafikut”**, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

- *Dokumentat e tenderit*
- *Termet e referencës/ specifikimet teknike*
- *Relacioni teknik*
- *Grafiku i ekzekutimit*
- *Struktura e Preventivit*

NJËSIA E PROKURIMIT